

Thirrje e Hapur nën Programin EIT Community NEB: Komunitetet lokale dhe autoritetet publike që ndërtojnë hapësira publike të qëndrueshme, të bukura dhe gjithëpërfshirëse 2025

Komuniteti i Institutit Evropian të Inovacionit dhe Teknologjisë (EIT) ka hapur thirrjen për projekt-propozime nën programin New European Bauhaus (NEB), e cila fokusohet në zgjidhje të reja për të nxitur transformimin e qyteteve, zonave rurale dhe periferike.

Qëllimi i thirrjes është të mbështesë projekte që lejojnë njerëzit dhe komunitetet të rimendojnë hapësirat e përbashkëta duke i afruar më pranë natyrës, ndërtuar një ndjenjë të përbashkët të përkatësisë dhe adresuar nevojat lokale.

Thirrja e programit NEB pranon aplikime për projekte që adresojnë sfida të lidhura me klimën, mobilitetin urban, ushqimin dhe prodhimin.

Propozimet duhet të përfshijnë tre vlerat themelore të NEB: qëndrueshmërinë, gjithëpërfshirjen dhe estetikën.

Kush mund të aplikojë

Në këtë thirrje mund të aplikojnë bashkitë, si dhe entitete të tjera si institucione arsimore, organizata kërkimore dhe teknologjike, OJQ ose entitete sociale, biznese të vogla dhe të mesme etj.

Të gjitha propozimet duhet të përbëhen nga një konsorcium me **minimum dy dhe maksimum katër partnerë** dhe njëri prej tyre duhet të jetë një **bashki, qark ose një entitet i lidhur me një bashki ose qark**.

Aktivitetet e mbështetura

Komuniteti EIT NEB përcakton katër fusha tematike:

- Rilidhja me natyrën;
- Rikthimi i ndjenjës së komunitetit dhe përkatësisë;
- Prioritizimi i vendeve dhe njerëzve që kanë nevojë më shumë për to;
- Nevoja për një cikël jetëgjatë dhe mendim të integruar në ekosistemet industriale.

Të gjitha aplikimet duhet të adresojnë të paktën një nga fushat e sfidave të Komunitetit EIT NEB të përmendura më sipër.

Fondi i Thirrjes

Në këtë thirrje do të përzgjidhen **8 projekte**, me një financim maksimal prej **45,000 EUR për projekt** dhe një normë minimale të **bashkëfinancimit** prej **25%**.

Afati i fundit për aplikim: 10 tetor 2024 në orën 17:00 CET

Linku i Thirrjes

<https://www.eiturbanmobility.eu/co-create-new-european-bauhaus-open-call-2025/>